



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
INSTITUTI I SIGURISË USHQIMORE DHE VETERINARISË

Raport Vjetor 2022

MISIONI I ISUV

- Qendra e Referencës Kombëtare kontribuon me aktivitetin e tij në fushën e sigurisë ushqimore, shëndetit të kafshëve, mbrojtjes e shëndetit të bimëve, nëpërmjet zbatimit të programeve kombëtare të kontrollit sipas strategjive, planeve të monitorimit si dhe kontrolleve zyrtare të miratuara në përputhje me vendimet e politikave të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.
- Në përputhje me rregulloret e BE-së, Rekomandimet e FVO-së dhe legjislacionin shqiptar, ky institucion ka objektiva për përmirësimin e infrastrukturës laboratorike, si dhe rritjen e kapaciteteve teknike, ruajtjen e kompetencës teknike nëpërmjet testeve të akredituara.
- Koordinon veprimtaritë e laboratorëve zyrtarë (LR) me qëllim harmonizimin dhe përmirësimin e metodave diagnostike laboratorike dhe përdorimit të tyre.

Realizimi i Planeve/programeve të Monitorimit

- Plani Kombëtar i Monitorimit të Mbetjeve në Produktet me Origjinë Shtazore dhe Ushqimet për Kafshë Urdhër nr 149 date 02.04.2021;
- Planet e kampionimit të zonës së rritjes dhe mbledhjes së molusqeve bivalvë të gjalla;
- Plani Kombëtar i Monitorimit të Mbetjeve të Pesticideve në Produktet me Origjinë bimore;
- Planet Kombëtare të monitorimit dhe kontrollit të sëmundjeve, (FMD, Blu Tang, CSF, AI)
- Programet e strategjive që lidhen me eradikimin e sëmundjeve zoonotike (Anthrax, Brucelozë, TBC);
- Planet e monitorimit post-vaksinal si Brucelozë REV 1 në të lmta, Tërbimi në dhelprën e kuqe.

- Kontrollat zyrtare lidhur me përcaktimin e shkakut të sëmundshmërisë ose ngordhshmërisë së specieve të ndryshme në kafshë, në shpendë dhe akuakulturë bazuar: *Ligji Nr. 10465 datë 29.09.2011 "Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë"*.
- Plani për marrjen e mostrave në kuadër të kontrollit zyrtar mbi prodhimin dhe tregtimin e produkteve të peshkimit nr. Prot 2236 dt. 08.03.2019.
- Planit me bazë risku të AKU-së.

Plotësimi i disa prej Rekomandimeve të FVO 2022

- Mirëmbajtja dhe zgjerimi i Akreditimit. Në Tetor të këtij viti u akordua certifikata e akreditimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit për 1368 teste, në fushën e sigurisë ushqimore dhe shëndetit të kafshëve .
 - Përmiresimi i infrastrukturës laboratorike, e cila ndikon në rritjen e performancës teknike.
 - Arritja e një marrëveshje bashkëpunimi me *Istituto Zooprofilattico e Sperimentale del Piemonte Liguria e Valle D`Aosta* me Nr. Prot.794 datë 22/09/2022, në të gjitha fushat e operimit të ISUV.
 - Garantimi i cilësisë së rezultateve dhe ruajtjes së kompetencës teknike nëpërmjet marrjes pjesë të stafit teknik në Teste ndërlaboratorike organizuar nga EURL si PHE-FEPTU, ANSES, VETQAS, Pirbright, FAPAS. Rezultatet e testeve kanë qenë të kënaqshme.
 - Zhvillimi i metodave të reja analitike me metoda LC-MS/MS; GCMS/MS të cilat do të ndikojnë në uljen e nënkontraktimeve dhe plotësimin e rekomandimeve të FVO-së.
- Në proces validimi i Antibakterialeve në vezë dhe qumësht
 - Në proces validimi i Nitroimidazoleve në vezë
 - Në proces validimi i Metaleve të Rënda në veshkë
 - Në proces validimi Metoda e Biologjise Molekulare per LSD
 - Në proces validimi Metoda e Biologjise Molekulare per PPR
 - Në proces validimi Metodat Serologjike për Newcastle disease
 - Zhvillimi i metodës për përcaktimin e Phenicols (Kloramfenikol, Thiamfenikol, Florfenikol) në vezë

1. Plani Kombëtar i Monitorimit të Mbetjeve të Pesticideve në Produktet me Origjinë Bimore

- Përmirësimi i infrastrukturës laboratorike
- Akreditimi i metodave instrumentale (LC/MC-MS, GC/MC-MS) për mbetjet e pesticideve në 3 grupe të produkteve me origjinë bimore ku përfshihen pothuajse të gjitha frutat dhe perimet e freskëta dhe të thara, për 1266 parametra analitik (referuar Certifikatës së Akreditimit).
- Realizimi në kohë i analizave për kampionet e ardhur.

Qëllimi i kampionimit	Nr. kampione të analizuar në raport me vitin paraardhës	Lloji i kampioneve	Parametrat analitik në raport me vitin paraardhës	Raste jo konform
Plani i Monitorimit dhe kontrole për eksport	300 kampione të analizuar/ 350 të ardhur	Fruta/perime sipas planit kombëtar të monitorimit.	430 parametra analitik në 2022/250 në 2021	39 kampione jokonform
Analiza cilësore të PMB-ve	40 kampione të analizuar/ 41 të ardhur (<i>Analizuar me Nënkontraktim</i>)	Sipas planit me bazë rishu AKU	Lëndet aktive	Rastet konform ose Jo vlerësohen nga AKU (analizë Cilësore)
Mbetjet e Nitrateve në perime gjethore	10 kampione të analizuar/ 10 të ardhur	Perime gjethore sipas planit me bazë rishu AKU	Nitrate	Asnjë rast jokonform

2. Plani Kombëtar i Monitorimit të Mbetjeve në Produktet me Origjinë Shtazore dhe Ushqimet për Kafshë

- Përmirësimi i infrastrukturës laboratorike (ngritja e laboratorit të ri të Mykotoxinave)
- Akreditimi i metodave instrumentale (LC/MC-MS, GC/MC-MS, ICP-MS, AAS) për mbetjet e pesticideve në qumësht , vezë, Aflatoksina M1 në qumësht, Metalet e Rënda (Pb, Cd, Hg) në produktet e peshkimit
- Realizimi i Planit është në proces deri në 31 janar 2023.
- Aktualisht kanë rezultuar 53 kampione jo-konform nga të cilat 12 kampione urinë, 25 kampione vezë, 2 kampione qumësht, 13 kampione mjaltë, 1 kampion muskul.

Qëllimi i kampionimit	Nr. kampione të analizuar në raport me vitin paraardhës	Lloji i kampioneve	Parametrat analitik në raport me vitin paraardhës
Plani Kombëtar i Monitorimit të Mbetjeve në Produktet me Origjinë Shtazore dhe Ushqimet për Kafshë	1964 kampione të analizuar / 3044 analiza për vitin 2022 krahasuar me 1986 kampione të analizuar për 3026 analiza për vitin 2021	Përfshihen Kafshët e gjalla (plazëm dhe urinë), produktet me origjinë shtazore (muskul, veshkë, mëlçi, dhjam, zorrë, vezë, qumësht), akuakulturë (peshk) dhe mjalt	138 parametra analitike

3. Plani Kombëtar i Monitorimit të Molusqeve

- Përmirësimi i infrastrukturës
- Akreditimi i metodave instrumentale (ICP-MS, AAS) për Metalet e Rënda (Pb, Cd, Hg) në produktet e peshkimit.

Qëllimi i kampionimit	Nr kampione te analizuara ne raport me vitin paraardhes	Lloji i kampioneve	Parametrat analitik ne raport me vitin paraardhes
Plani i Monitorimit dhe kontrole për eksport	16 kampionë të analizuara për 2022 në krahasim me 19 kampione të analizuara për 2021	Ujë deti dhe molusqe	Metalet e Rënda (Pb, Cd, Hg)

4. Plani Kombëtar i Monitorimit të Molusqeve

- Përmirësimi i infrastrukturës laboratorike
- Mirëmbajtja e akreditimit për 86 teste në fushën e mikrobiologjisë ushqimore, cilësisë së ushqimeve dhe kontrollit të produkteve peshkore.

Qëllimi i kampionimit	Nr kampione të analizuara në raport me vitin paraardhës	Lloji i kampioneve	Parametrat analitik në raport me vitin paraardhës
Plani i Monitorimit	862 kampion/1034 analiza krahasuar me 2021 1035 kampione /1242 analiza	Molusqe, ujë deti, alga bentonike	E. coli, Salmonella spp., PSP, DSP, ASP, Fitoplankton potencialisht toksik

5. Plani Kombëtar i Monitorimit të Peshkut

Qëllimi i kampionimit	Nr kampione të analizuar në raport me vitin paraardhës	Lloji i kampioneve	Parametrat analitik në raport me vitin paraardhës
Plani i Monitorimit të peshkut	120 kampione të analizuar për 120 analiza për 2022 në krahasim me 90 kampione të analizuar për 90 analiza për 2021	Produkte peshkimi (peshk, acuge, kallamar)	Pesticidet klororganike dhe fosfororganike, (26 parametra analitike)

6. Planet Kombëtare të monitorimit dhe kontrollit të sëmundjeve

Treguesi Analitik	Nr.Kampioneve - sipas Planifikimit	Nr . Analizave	Raste jo konform
Bruceloza në Gjedh (Akredituar)	4705 Ferma	4705	8 ferma (konfirmuara)
Bruceloza ne Gjedh -individual (Akredituar)	263	548	36 krerë (të konfirmuar)
REV 1 në të lmta (Akredituar)	1121	1121	
Afta Epizotike (Akredituar)	350	Proces	
Tërbimi ne dhelprat e kuqe (Akredituar)	267	801	
Influcë aviare (Akredituar)	1031	1431	10
Blu Tang	841	356	55

7. Programe te kontrollit të sëmundjeve, zbatimin e strategjive që lidhen me eradikimin e sëmundjeve zoonotike si dhe kontrollet zyrtare.

Treguesi Analitik	Nr.Kampioneve - sipas Planifikimit	Nr . Analizave	Raste jo konform
Tuberkuloz		2	2
Anthrax		65	20
Anisakis spp. (Akredituar)		60	0
<i>Brucelozë (abort, shendetesim)</i>	957	1715	12 Ferma 103 krere
Influenca aviare (biologji molekulare) (Akredituar)		292	75
<i>Maedi Visnae në dhen (MV)</i>	341	348	
Murtaja Klasike (Akredituar)	-	58	0

Aktiviteti analitik në kuadër të kontrolleve zyrtare/autokontrollit

Në lidhje me **kontrollet zyrtare të Planit me bazë risku të AKU** janë analizuar:

- 83 kampione për metale të rënda (Pb,Cd,Hg)
- 7 kampionë për Mykotoxinat (Aflatoxinë M1 dhe Aflatoxinë B1)

Në lidhje analizat **me qëllim eksporti** janë analizuar:

- 15 kampione për metale të rënda (Pb,Cd,Hg)
- Treguesit e cilësisë, treguesit mikrobiologjik si dhe treguesit e freskisë:
- Zyrtare 1408 kampione dhe 7608 analiza
- Autokontroll 1113 kampione dhe 11362 analiza

Në lidhje me **kontrollet zyrtare për diagnozën në kafshë dhe shpendë:**

- 197 kampione /595 analiza diagnozë shëndet kafshësh.